



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Në mbështetje të nenit 31 dhe nenit 64, paragrafi 1, pika 22 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 3/2002, 51/2003, 85/2003, 40/2004, 61/2005 dhe 129/2006); nenit 114, paragrafi 2 dhe nenit 121 të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/2007), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi:

V E N D I M

për mbikëqyrje të konsoliduar

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/2008)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet:

- mënyra e mbikëqyrjes së konsoliduar të një grupi bankar;
- lënda e konsolidimit dhe përmbajtja e raporteve të konsoliduara për qëllimet e mbikëqyrjes së konsoliduar dhe
- mënyra dhe afatet e raportimit në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore).

2. Mbikëqyrja e konsoliduar paraqet mbikëqyrjen e situatës financiare dhe të rreziqeve ndaj të cilave janë të ekspozuara bankat, si rezultat i lidhjes së tyre me persona të tjerë në kuadër të grupit bankar.

3. Si bankë e cila në përputhje me Ligjin e Bankave është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar, konsiderohet banka me seli në Republikën e Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: RM) e cila është:

- person amë i grupit bankar; ose
- filial i shoqërisë financiare holding me seli në RM, që është person amë i grupit bankar.

II. MËNYRA E MBIKËQYRJES SË KONSOLIDUAR

4. Banka Popullore bën mbikëqyrjen e konsoliduar të grupit bankar, duke zbatuar rregullat dhe procedurat e mbikëqyrjes së një banke individuale, të përcaktuara me Ligjin e Bankave dhe me aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji.

5. Banka Popullore, si autoriteti kompetent mbikëqyrës për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupit bankar, është gjithashtu përgjegjëse për koordinimin e qasjes së përbashkët për mbikëqyrjen e konsoliduar, me autoritetet mbikëqyrëse vendase dhe të huaja kompetente për mbikëqyrjen dhe licencimin e personave të tjerë në grupin bankar.

Koordinimi sipas paragrafit 1 të kësaj pike përfshin:

- mbledhjen dhe shpërndarjen e informacioneve që shkëmbehen ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse, në përputhje me Ligjin e Bankave;
- planifikimin dhe zbatimin e mbikëqyrjes së konsoliduar.

Sipas këtij vendimi, autoritete vendase mbikëqyrëse janë: Komisioni i Letrave me Vlerë, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve Pensionale me Financim Kapital, Ministria e Financave dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

6. Për të zbatuar një qasje të përbashkët për mbikëqyrjen e konsoliduar të një grupi bankar, Banka Popullore lidh marrëveshje të veçanta me autoritetet mbikëqyrëse vendase.

7. Marrëveshjet e pikës 6 të këtij vendimi mund të lidhen në baza dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe përfshijnë memorandumet bashkëpunimi të lidhura ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse.

Me marrëveshjet e paragrafit të kësaj pike përcaktohet shkëmbimin e informatave ndërmjet Bankës Popullore dhe autoriteteve të tjera mbikëqyrëse për të dhënë leje dhe pëlqime, zbatimin e mbikëqyrjes dhe ndërmarrjen e masave.

8. Në rast se një bankë që ka selinë në Republikën e Maqedonisë, është pjesë e një grupi, personi amë e të cilës është një bankë, institucion kredie ose shoqëri financiare holding që ka selinë jashtë Republikës së Maqedonisë, Banka Popullore bashkëpunon me autoritetet mbikëqyrëse përgjegjëse për licencimin dhe mbikëqyrjen e shoqërisë amë dhe të personave të tjerë në grup, të paktën në mënyrën e përcaktuar sipas Ligjit të Bankave, e që i referohet zbatimit të një qasjeje të përbashkët për mbikëqyrjen e konsoliduar.

9. Në rast se një bankë që ka selinë në Republikën e Maqedonisë, është pjesë e një grupi, personi amë e të cilës është një institucion tjetër financiar, përveç institucioneve nga pika 8 të këtij vendimi, që ka selinë brenda dhe jashtë Republikës së Maqedonisë, Banka Popullore bashkëpunon me autoritetet mbikëqyrëse përgjegjëse për licencimin dhe mbikëqyrjen e personit amë dhe të personave të tjerë në grup, të paktën në mënyrën e përcaktuar sipas Ligjit të Bankave, e që i referohet zbatimit të një qasjeje të përbashkët për mbikëqyrjen e konsoliduar.

10. Nëse organi mbikëqyrës i shoqërisë amë nga pikat 8 dhe 9 të këtij vendimi, që ka selinë jashtë Republikës së Maqedonisë, dëshiron të bëjë kontroll terreni të drejtpërdrejtë të bankës që ka selinë në Republikën e Maqedonisë, është i detyruar të dorëzojë një njoftim me shkrim në Bankën Popullore.

Pas njoftimit nga paragrafi 1 të kësaj pike, Banka Popullore mund të veprojë në njërin nga këto mënyra:

- të bazojë vet kontrollin e drejtpërdrejtë në terren;
- t'i mundësojë autoritetit mbikëqyrës të zbatojë kontroll të drejtpërdrejtë në terren; ose
- të organizojë kontroll të përbashkët të drejtpërdrejtë në terren.

11. Për të zbatuar bashkëpunimin dhe mbikëqyrjen sipas pikave 8, 9 dhe 10 të këtij vendimi, Banka Popullore dhe autoritetet e tjera mbikëqyrëse mund të lidhin marrëveshje në baza bilaterale dhe shumëpalëshe, ku përfshihen edhe memorandumet e bashkëpunimit të lidhura ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse.

III. LËNDË E KONSOLIDIMIT DHE PËRMBAJTJE E RAPORTIEVE TË KONSOLIDIMIT PËR GRUP BANKAR

12. Grupi bankar është i detyruar të punojë në atë mënyrë që të sigurojë respektimin e dispozitave të Ligjit të Bankave që i referohen një banke individuale.

13. Grupi bankar duhet të organizohet në atë mënyrë që bankës, e cila është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar, t'i mundësojë të jetë në gjendje të monitorojë rreziqet ndaj të cilave grupi është i ekspozuar dhe të ndërmarrë masa për të menaxhuar këto rreziqe.

Çdo person nga grupi bankar duhet të ketë sistemet e përshtatshme që do të mundësojnë marrjen e të dhënave dhe informacioneve të nevojshëm për qëllimet e mbikëqyrjes së konsoliduar.

14. Banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar është e detyruar të përpilojë raporte të konsoliduara për grupin bankar.

Raportet e konsoliduara të paragrafit 1 të kësaj pike përbëhen nga raportet financiare të konsoliduara dhe raportet e konsoliduara mbikëqyrëse.

15. Raportet e konsoliduara përpilohen me zbatimin e duhur të dispozitave të Ligjit të Bankave dhe me aktet nënligjore të përcaktuara në bazë të këtij ligji, duke marrë parasysh dispozitat e këtij kreu.

III. 1 Raporte financiare të konsoliduara

16. Raportet financiare të konsoliduara të grupit bankar, për qëllimet e mbikëqyrjes së konsoliduar, përbëhen nga:

- Bilanci i suksesit;
- Bilanci i gjendjes;
- Raporti i ndryshimeve në kapitalin dhe në rezervat;
- Raporti i rrjedhjes së parave;
- Vërejtjet ndaj raporteve financiare.

17. Për qëllimet e mbikëqyrjes së konsoliduar, raportet financiare të konsoliduara përgatiten duke përdorur metodën e konsolidimit të plotë të të gjitha filialeve në grupin bankar.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, raportet financiare të konsoliduara të përgatitura për qëllimet e mbikëqyrjes së konsoliduar, në përputhje me metodën e konsolidimit të plotë, nuk përfshijnë raportet financiare të filialeve - shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit.

18. Me përjashtim të pikës 17, paragrafi 1 të këtij vendimi, në rastet kur përgjegjësia e shoqërisë amë është e përcaktuar qartë dhe e kufizuar në pjesën e saj në kapitalin e shoqërisë vartëse, pra kur përgjegjësia e aksionarëve ose ortakëve të tjerë mund të përcaktohet qartë, mund të përdoret metoda proporcionale e konsolidimit gjatë përpilimit të raporteve financiare të konsoliduara të një grupi bankar për qëllimet e mbikëqyrjes së konsoliduar.

Krahas rasteve nga paragrafi 1 të kësaj pike, metoda e konsolidimit proporcional mund të zbatohet edhe për pjesëmarrjet në kapitalin e personave që drejtohen nga një person vartës që përfshihet në konsolidim, së bashku me një ose më shumë persona të tjerë që nuk përfshihen në konsolidim, nëse përgjegjësia e këtyre personave kufizohet në pjesëmarrjen e tyre në kapital.

Për të përcaktuar përgjegjësinë e aksionarëve apo ortakëve të tjerë, banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar, është e detyruar t'i paraqesë Bankës Popullore dëshmi të duhur për:

- mënyrën e rregullimit të të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella të aksionarëve ose ortakëve individualë;
- shumën e kapitalit të aksionarëve ose ortakëve të tjerë;
- shumën dhe mënyrën e llogaritjes së shkallës së mjaftueshmërisë së kapitalit ose një tregues tjetër të përshtatshëm nga i cili mund të përcaktohet aftësia e pagesës e aksionarëve ose e ortakëve të tjerë.

Nëse në bazë të të dhënave të dorëzuara, Banka Popullore konstaton se nuk janë plotësuar kushtet për zbatimin e metodës proporcionale të konsolidimit, do të urdhërojë bankën që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar që të përfshijë personat e paragrafëve 1 dhe 2 të kësaj pike në raportin financiar të konsoliduar, duke zbatuar metodën e konsolidimit të plotë. Banka e cila është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar, është e detyruar t'i dorëzojë raportet e reja financiare të konsoliduara brenda një muaji pas njoftimit të marrë nga Banka Popullore.

19. Në rastin e pjesëmarrjes në kapitalin e personave vartës në grupin bankar, ndryshe nga pjesëmarrja e pikave 17 dhe 18 të këtij vendimi, konsolidimi bëhet duke zbatuar metodën e kryegjësë.

Metoda e kryegjësë zbatohet edhe për pjesëmarrjen në kapitalin e personave të pikës 17, paragrafi 2 të këtij vendimi.

20. Një person vartës nuk do të përfshihet në raportet financiare të konsoliduara, për qëllimet e mbikëqyrjes së konsoliduar, në këto raste:

- nëse e ka selinë jashtë RM-së, në një vend ku ka pengesa ligjore për transferimin e informacioneve të nevojshëm për qëllimet e mbikëqyrjes së konsoliduar;
- nëse përfshirja nuk ndikon ndjeshëm në situatën financiare të grupit bankar, si dhe në rastet kur totali i aktives së personit vartës është më pak se 1% e aktives së personit amë. Nëse disa persona vartës e plotësojnë këtë kusht, këta persona do të përjashtohen nga konsolidimi, në rast se së bashku nuk kalojnë 1% të aktives së personit mëmë.;
- nëse pjesëmarrja në kapitalin e personit vartës është fituar nga personi amë, me synimin për ta tjetërsuar gjatë 12 muajve të ardhshëm;
- nëse përfshirja në konsolidim do të shkaktonte përfundime të gabuara ose të papërshtatshme në lidhje me qëllimet e mbikëqyrjes së konsoliduar.

Pavarësisht bazës për përjashtimin nga konsolidimi, të gjithë personat vartës mbeten të detyruar të dorëzojnë informacionin e nevojshëm në bankën që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar, në përputhje me Ligjin e Bankave.

21. Banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar, është e detyruar të njoftojë Bankën Popullore për personat e grupit bankar që synon të përjashtojë dhe për arsyet e përjashtimit të tyre, 30 ditë pune para datës së përgatitjes së raporteve financiare të konsoliduara.

22. Në bazë të arsyeve të theksuara në njoftimin sipas pikës 21 të këtij vendimi, Banka Popullore, brenda 10 ditësh pune, vlerëson nëse qëllimi i propozuar i konsolidimit ofron një paraqitje të plotë dhe të saktë të gjendjes financiare të grupit bankar.

IV. 1 Raporte mbikëqyrëse të konsoliduara

23. Raportet e konsoliduara mbikëqyrëse përbëhen nga raportet përkatëse për:

- shumën e mjeteve vetjake, aktiven e ponderuar sipas rrezikut dhe shkallës së mjaftueshmërisë së kapitalit;
- ekspozimet e mëdha;
- investimet në aksione kapitale në institucionet jofinanciare.

Raportet e mbikëqyrjes së konsoliduar përpilohen në bazë të raporteve financiare të konsoliduara të grupit bankar dhe me zbatimin e duhur të rregullave të përcaktuara me aktet nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të Bankave që i referohen përpilimit të raporteve të paragrafit 1 të kësaj pike.

V. MËNYRA DHE AFATE TË RAPORTIMIT TË BANKËS POPULLORE

24. Banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar, është e detyruar t'i paraqesë Bankës Popullore një raport për përbërjen e grupit bankar dhe raporte të konsoliduara për grupin bankar.

V.1 Raport për gjendjen e grupit bankar

25. Raporti i përbërjes së grupit bankar duhet të përmbajë listën e personave individualë në grup dhe përshkrimin e lidhjes së tyre.

Të dhënat për personat në grup duhet të përmbajnë: emrin dhe selinë e personit, numrin e amzës, veprimtarinë mbizotëruese, shumën totale të aktives, shumën e kapitalit, përkatësisht mjetet vetjake, pjesën në kapital dhe/ ose të drejtat e votës të personave të tjerë në grup, të dhëna për anëtarët e organeve mbikëqyrëse dhe drejtuese të personave që përbëjnë grupin bankar, emrin e autoriteteve mbikëqyrëse që kanë dhënë lejen për krijimin dhe punën e personave në grup, emrin e shoqërisë së auditimit që do të auditojë raportet financiare të konsoliduara.

Marrëdhëniet ndërmjet personave në grup dhe lloji i lidhjes paraqiten në formën e një pamjeje skematike, nga e cila do të mund të përcaktohen pjesëmarrjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në kapital dhe/ose të drejtat e votës së personave të tjerë në grupi.

26. Banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar, është e detyruar të paraqesë raportin e pikës 25 të këtij vendimi me gjendjen në fund të çdo viti kalendarik, deri më 31 janar të vitit të pasardhës.

27. Nëse gjatë vitit ka ndryshime në përbërjen e grupit bankar, ndryshime në të dhënat e pikës 25, paragrafi 2, që i referohen çdo personi individual ose marrëdhënieve ndërmjet individëve të grupit, banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar është e detyruar t'i dërgojë njoftim Bankës Popullore në afat prej 30 ditësh pune, pas ndryshimeve të ndodhura.

28. Me kërkesë të veçantë të Bankës Popullore, banka që i është pjesë e mbikëqyrjes së konsoliduar, është e detyruar të përpilojë raportin e pikës 25 të këtij vendimi, për gjendjen në një ditë tjetër dhe brenda një afati tjetër, që janë të ndryshme nga gjendja dhe afati i përcaktuar sipas pikës 26 të këtij vendimi.

29. Në rastet kur, në përputhje me Ligjin e Bankave, nuk ekziston një grup bankar, bankë që ka selinë në RM, që është filial i një personi tjetër juridik, ose që është personi amë i një personi tjetër juridik, është e detyruar të dorëzojë në Bankën Popullore një Raport për përbërjen e grupit, të përpiluar në përputhje me pikën 25 të këtij vendimi.

Raporti për përbërjen e grupit dorëzohet nga banka e paragrafit 1 të kësaj pike brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 26 të këtij vendimi.

Nëse Banka Popullore, në bazë të raportit për përbërjen e grupit konstaton ekzistimin e grupit bankar, do të urdhërojë bankën e paragrafit 1 të kësaj pike ose një bankë tjetër që, në përputhje me Ligjin e Bankave, do të konsiderohet bankë që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar, për të përpiluar raporte të konsoliduara, si dhe për të përcaktuar afatet në të cilat banka është e detyruar të fillojë të dorëzojë këto raporte në Bankën Popullore.

V. 2 Raporte të konsoliduara të grupit bankar

30. Raportet e konsoliduara për grupin bankar përpilohen në baza gjashtë mujore si::

- raporte të konsoliduara të parishikuar, me gjendjen më 30 qershor; dhe
- raporte të konsoliduara të parishikuara, me gjendjen më 31 dhjetor.

Afati i dorëzimit të raporteve të paragrafit 1, nënparagrafi 1 të kësaj pike është 30 shtatori i vitit aktual, ndërsa afati i dorëzimit të raporteve të paragrafit 1, nënparagrafi 2 të kësaj pike është 30 maji i vitit të pasardhës.

31. Me kërkesë të veçantë të Bankës Popullore, banka që është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar, është e detyruar të përpilojë raportet e pikës 30 të këtij vendimi, me gjendjen në një ditë tjetër dhe brenda një afati tjetër, që janë të ndryshme nga gjendja dhe afati i përcaktuar sipas pikës 30 të këtij vendimi.

VI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

32. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, përfundon së vlefshmi Vendimi për mbikëqyrjen e konsoliduar të bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 84/2003).

O. nr. 02-15/I-4/2008

31.01. 2008

Shkup

Mr. Petar Goshev

guvernator

dhe kryesues

i Këshillit të Bankës Popullore

të Republikës së Maqedonisë